



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



ZKA

ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT
NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE
NATIONAL AUDIT OFFICE

RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË KOMUNËS SË GJILANIT PËR VITIN 2024

Prishtinë, maj 2025

PËRMBAJTJA E RAPORTIT

- 1 Opinioni i Auditimit
- 2 Gjetjet dhe rekomandimet
- 3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit
- 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shtojca I: Letër konfirmimi

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

1 Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Komunës së Gjilanit për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2024, në përputhje me Ligjin për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.¹

Opinion i kualifikuar për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Gjilanit (KGJ), të cilat përmbajnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, raportin e ekzekutimit të buxhetit si dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe raportet tjera², për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2024.

Sipas opinionit tonë, përveç ndikimit të çështjes/ve të përshkruara në paragrafin për Bazën për Opinion të Kualifikuar, Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Gjilanit, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme, Ligjin nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe Rregulloren MF, Nr. 01/2017 për raportim vjetor financiar nga organizatat buxhetore.

Baza për Opinion të Kualifikuar

- A1 Detyrimet e papaguara të prezantuara (2,855,994€) në nenin 17 të Pasqyrat Financiare Vjetore (PFV) ishin të mbivlerësuara për 49,692€.
- A2 Pasuritë Kapitale të prezantuara (242,847,020€) në nenin 19.3.1 të PFV ishin të nënvlerësuara për 18,538€.
- B1 Komuna ka paguar dhe regjistruar shpenzime në vlerë 1,987,278€ nga kategori ekonomike jo adekuate.

Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.1 Çështjet që ndikojnë në opinion të auditimit

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Konkluzion për pajtueshmërinë

Ne kemi audituar nëse proceset dhe transaksionet përcjellëse janë në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas mendimit tonë, përveç ndikimeve të çështjes/ve të përshkruara në seksionin Baza për Konkluzion të pajtueshmërisë, transaksionet e kryera në procesin e ekzekutimit të buxhetit Komunës së Gjilanit kanë qenë, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Baza për konkluzion

- A3 Zhvillimi i procedurës së prokurimit në kundërshtim me kërkesat ligjore.
- B2 Pagesa e projekteve në kundërshtim me ligjin e buxhetit.
- B3 Vonesa në kryerjen e obligimeve të papaguara, si dhe pagesa të realizuara nga Thesari, në bazë të vendimeve gjyqësore/përmbartimore ishte 7,006,316€. Prej tyre borxhi kryesor ishte 6,483,260€, ndërsa 523,056€ ishin shpenzime të interesit dhe procedurale të gjykatës/përmbartimit.
- B4 Vonesa në procesin e vlerësimit të tenderëve.
- B5 Komuna kishte të angazhuar 102 zyrtarë me kontrata për shërbime të veçanta, dhe për ta nuk kishte zhvilluar procedura të prokurimit siç kërkohet me ligjin për zyrtarët publik.
- B6 Komuna nuk kishte arritur ta bëjë inspektimin (verifikimin) të tatimi në pronë për të paktën 20% e të gjitha objekteve brenda territorit të Komunës.

Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore

Kryetari i Komunës është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, Kryetari i Komunës është përgjegjës edhe për vendosjen e kontroleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundur përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Kryetari i Komunës është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Komunës së Gjilanit.

Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë

Menaxhmenti i Komunës së Gjilanit është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të Komunës së Gjilanit në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësinë dhe të gjitha rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.³

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Objektivat tona janë të ofrojmë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të hartojmë një raport të auditimit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq-deklarimet mund të vijnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose si tërësi, në mënyrë të arsyeshme pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Objekti ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të Komunës së Gjilanit me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare, lidhur me subjektin e audituar.

Si pjesë e auditimit në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticizëm profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keq-deklarimit material të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinionin. Rreziku i mos zbulimit të një keq-deklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontroleve të brendshme.
- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme, por jo me qëllim të shprehjes së një opinionimi mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Komunës së Gjilanit.

- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet e ndërlidhura të bëra nga menaxhmenti.
- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë shpalosjet, për t'u siguruar se pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet themelore në mënyrë të drejtë dhe të saktë.

Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuara me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si senzitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

2 Gjetjet dhe rekomandimet⁴

Gjatë auditimit, kemi identifikuar fusha në të cilat nevojiten përmirësime në menaxhimin financiar dhe kontrollin. Në veçanti, kemi identifikuar dobësi në: klasifikimin e shpenzimeve, menaxhimin e pasurive, të hyrave, llogarive të arkëtueshme, obligimeve të papaguara, menaxhimin e kontratave për investime kapitale, si dhe në procedurat e prokurimit publik. Këto çështje janë paraqitur si gjetje dhe rekomandime të mëposhtme për t'u shqyrtuar.

Këto gjetje dhe rekomandime kanë për qëllim të bëjnë korrigjimin e nevojshëm të informacionit financiar të paraqitur në pasqyrat financiare, duke përfshirë shpalosjet në formë të shënimeve shpjeguese dhe të përmirësojnë kontrollet e brendshme lidhur me raportimin financiar dhe pajtueshmërinë me autoritetet në lidhje me menaxhimin e fondeve të sektorit publik. Ne do t'i përcjellim (shqyrtojmë) këto rekomandime gjatë auditimit të vitit të ardhshëm.

Raporti ynë ka rezultuar me 14 rekomandime prej tyre gjashtë (6) janë rekomandime të reja, tetë (8) të përsëritura, për përmirësimin e këtyre aspekteve të menaxhimit financiar dhe kontrolleve. Shuma e pagesave të realizuara nga Thesari, në bazë të vendimeve gjyqësore/përmbarimore ishte 7,006,316€. Prej tyre borxhi kryesor ishte 6,483,260€, ndërsa 523,056€ ishin shpenzime të interesit dhe procedurale të gjyqësorit/përmbarimit.

Derisa për statusin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe nivelin e zbatimit të tyre, shih kapitullin 4.

2.1 Çështjet që ndikojnë në opinionin e auditimit

Çështja A1 - Mbivlerësimi i detyrimeve (faturave) të pa paguara.

Gjetja

Sipas Nenit 17.1 të Rregullores 01/2017 për Pasqyrat financiare vjetore të organizatave buxhetore: Zyrtari Kryesor Financiar i organizatës buxhetore është përgjegjës për të siguruar që çdo faturë e vlefshme dhe kërkesë për pagim për mallrat dhe shërbimet e furnizuara dhe/ose punët e realizuara për organizatën buxhetore të paguhen brenda tridhjetë (30) ditëve kalendarike pas pranimit të faturës ose kërkesës për pagim nga organizata përkatëse buxhetore.

17.3 Organizatat buxhetore raportojnë të gjitha detyrimet (faturat) të krijuara deri më 31 dhjetor të vitit raportues.

Detyrimet e papaguara të prezantuara (2,855,994€) në nenin 17 të Raportit Vjetor Financiar (RVF) ishin të mbivlerësuara për 49,692€, pasi komuna i kishte raportuar si obligime të papaguara faturat të cilat veçse ishin paguar gjatë vitit 2024.

Prezantimi jo i plotë dhe i saktë i Detyrimeve të pa paguara në PFV kishte ndodhur për shkak se personat përgjegjës nuk kishin ndjekur rregullat e pranimit të faturave dhe nuk kanë mbajtur të azhuruar regjistrin e faturave të pa paguara për prezantimin e saktë të vlerave në PFV.

Ndikimi

Mos shpalosja e saktë e detyrimeve të papaguara ka ndikuar në mbivlerësimin e tyre dhe mund të shpie në keqkuptimin e aktiviteteve financiare të komunës. Rrjedhimisht kjo, së bashku me gabimet tjera ndikon në opinionin e auditimit.

Rekomandimi A1 Kryetari, duhet të forcoj kontrollet e brendshme për të siguruar se janë ndërmarrë veprime për adresimin e shkaqeve që kanë ndikuar në mbivlerësimin e detyrimeve të pa paguara për të siguruar se shpalosjet e tyre janë të plota dhe të sakta në PFV.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A2 - Mos regjistrimi i pasurisë mbi 1000€ në regjistrin e pasurive në SIMFK

Gjetja Rregullorja MF-NR. 02/2013 për menaxhimin e pasurisë jo financiare në organizatat buxhetore, Neni 6.1 përcakton se, çdo organizatë buxhetore duhet të krijojë dhe azhurnoj regjistrin e pasurive jo financiare që i ka në menaxhimin e saj. Regjistri duhet të mbahet ndaras për çdo pasuri dhe në formë të agreguar sipas kategorive të klasifikuara në bazë të planit kontabël, si dhe Neni 6.3. përcakton se, Pasuria kapitale duhet të regjistrohet në SIMFK ndërsa pasuria jo kapitale dhe stoqet duhet të regjistrohet në sistemin “e-pasuria”.

Pasuritë e mëposhtme nuk ishin regjistruar si pasuri kapitale, duke nënvlerësuar regjistrin e pasurisë kapitale:

- Pajisjet e blera nga kodi ekonomik (13512) Pajisje shkencore në vlerë 18,538€, nuk ishin regjistruar në regjistrin e pasurisë në SIMFK, edhe pse vlera e tyre për një artikull është mbi 1,000€.

Vlera e pasurisë së paregjistruar ishte gjithsej: 18,538€.

Mangësitë e identifikuar lidhur me regjistrimet e pasurisë, kanë ndodhur për shkak të dobësive të zyrtarëve të pasurisë në zbatimin e drejtë të kontrolleve të brendshme lidhur me pasuritë.

Ndikimi Mangësitë e identifikuar në menaxhimin e pasurisë, kanë ndikuar në nënvlerësimin e pasurive në PFV. Po ashtu, menaxhimi jo i mirë mund të këtë ndikim në tjetërsimin apo humbjen e pasurive me të cilat është ngarkuar komuna.

Rekomandimi A2 Kryetari duhet të sigurojë se do të përmirësoj kontrollet lidhur me regjistrimin e pasurive që të gjitha pasuritë e komunës janë regjistruar në regjistra përkatës, të bëhet azhurnimi i regjistrave kontabël të pasurive përpara përgatitjes së pasqyrave financiare si dhe të shpalosen saktë në PFV.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B1 - Keqklasifikim i shpenzimeve

Gjetja Sipas Rregullës Financiare Nr. 01/2013/MF “Mbi shpenzimin e parasë publike” shpenzimet duhet të kenë kodet adekuate, të përcaktuara me Udhëzimin Administrativ për planin kontabël, po ashtu me planin kontabël të Thesarit janë përcaktuar kodet dhe kategoritë përkatëse të shpenzimeve që OB duhet të aplikojnë.

Nga testimi i mostrave, kemi vërejtur keqklasifikime të shpenzimeve nëpër kategori ekonomike në vlerë 1,825,594€. Nga kjo vlerë, thesari kishte

paguar sipas vendimit përmbarimor të gjykatës për paga jubilarë dhe shujta për arsimtar nga kategoria e investimeve kapitale 1,076,013€, nga kategoria mallrave dhe shërbimeve 740,198€ dhe nga kategoria e subvencioneve dhe transfereve 9,383€. Pagesat nga kategoritë ekonomike jo adekuate janë ekzekutuar nga Thesari. Në fund të vitit 2024, komuna kishte bërë kërkesës në Ministri për aprovimin e buxhetit shtesë në kategorinë e pagave dhe shtesave, por kjo nuk kishte ndodhur.

Po ashtu, komuna ka paguar dhe regjistruar shpenzime në vlerë 161,684€ nga kategoria ekonomike joadekuate. Këto pagesa janë kryer nga Komuna si rezultat i keq buxhetimit dhe gabimeve në klasifikimin e shpenzimeve të shkaktuara nga vet komuna dhe kanë të bëjnë me shpenzime për mirëmbajtje verore të rrugëve në Komunën e Gjilanit dhe duhej të ishin buxhetuar dhe paguar nga kategoria ekonomike mallra dhe shërbime e jo nga investimet kapitale.

Kjo kishte ndodhur për shkak të mungesës së ndarjeve buxhetore në kategorinë ekonomike adekuate për ti realizuar pagesat e vendimeve gjyqësore përmbarimore.

Ndikimi

Pagesat e bëra nga kategoria jo-adekuate, shpien në paraqitjen e shënimeve të gabuara në Pasqyrat Financiare të Komunës, ku të dhënat për kategori të shpenzimeve nuk janë të sakta dhe si të tilla japin informata çorientuese për shfrytëzuesit e PVF-ve.

Rekomandimi B1

Kryetari duhet të sigurojë që në kordinim me Ministrin e Financave, Punës dhe Transfereve janë ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme që shpenzimet të planifikohen në ndarjet adekuate të buxhetit apo të bëhet ridestnimi i mjeteve që pagesa dhe regjistrimi i transaksioneve të bëhet sipas kategorive ekonomike adekuate.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Çështja A3 - Zhvillimi i procedurës së prokurimit në kundërshtim me kërkesat ligjore

Gjetja

Rregullorja nr. 001/2022 për prokurimin publik pika 54.15 thekson se kurdo që autoriteti kontraktues nuk dine sasi të indikative, kontratat me çmime për njësi, AK duhet të përcaktoj peshën në baze të rëndësisë së secilës "kategori të shërbimeve" ose secilit "artikull" në mënyrë që Autoriteti Kontraktues të përcaktoj se cila është oferta me çmim më të ulët. Në këto raste nuk vlen pragu apo tavani plus/minus tridhjetë përqind (30%), si p.sh. mirëmbajtje të veturave, mirëmbajtje të gjeneratorëve etj. në këto raste në hapje publike të ofertave lexohet çmimi total i poentuar (peshuar) i cili shërben vetëm për qëllim të vlerësimit të ofertave ndërsa kontrata lidhet me çmime për njësi dhe mund të realizohet deri në vlerë të parashikuar. Shuma e sigurimit të ekzekutimit të kontratës në këto raste duhet të përcaktohet si shumë fikse. Kontratat me çmime për njësi mund të udhëhiqen për të gjitha llojet e kontratave, kontratë për furnizime, shërbime dhe punë (riparime dhe mirëmbajtje).

Te kontrata publike kornizë me (çmimi për njësi) "Mirëmbajtja teknike e objekteve" me vlerën totale indikative 1,280.000€, te aneksi një (1) i dosjes së tenderit ishte dhënë edhe devijimi i lejuar $\pm 30\%$, dhe në bazë të kësaj është lidhur edhe kontrata, që është në kundërshtim me kërkesat e rregullores së prokurimit publik.

Arsyeja përse kishte ndodhur kjo është mungesa e funksionimit të kontrolleve të brendshme, dhe pakujdesia e zyrës e prokurimit për ti evituar këto çështje.

Ndikimi

Lidhja e kontratës duke aplikuar devijimin $\pm 30\%$, nuk është në pajtim me kërkesat ligjore, si dhe njëherit kjo ndikon në rritjen e shpenzimeve shtesë të paarsyeshme dhe të paplanifikuara të parasë publike si dhe mund të ndikon në rritjen e obligimeve komunale.

Rekomandimi A3

Kryetari duhet të siguroj se procedura e prokurimit do të zhvillohet në pajtim me kërkesat e Ligjit të prokurimit publik, dhe kur autoriteti kontraktues nuk i di sasi të indikative me çmim për njësi atëherë nuk duhet të përfshihet në kontratë edhe devijimi $\pm 30\%$.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B2 - Pagesa e projekteve në kundërshtim me ligjin e buxhetit.

Gjetja

Sipas neni 16 pikës 11 të Ligjit mbi ndarjet buxhetore për vitin 2024 nr. 08/L-260, Ndryshimet në shumat e ndara buxhetore për projektet ekzistuese si rezultat i transfereve dhe/ose rialokimeve, të prezantuara në tabelën 4.2, duke përfshirë edhe të hyrat vetanake të bartura, si dhe të regjistruara në SIMFK, duhet të aprovohen paraprakisht nga Kuvendi Komunalë. Të gjitha këto ndryshime aprovohen nga Ministri.

Në katër (4) pagesa të testuara në vlerë prej 138,714€, kemi identifikuar se komuna ka përdorur fondet për projekte tjera nga ato për të cilat ishin

planifikuar/buxhetuar. Në këto raste, nuk ka pasur aprovim nga Kuvendi Komunal për ridestitim të fondeve dhe rialokimit të ndarjeve buxhetore nga një projekt kapital në një tjetër.

Mos zbatimi i kërkesave ligjore ishte për shkak të pagesave direkte nga thesari për vendime gjyqësore/përmbartimore projekte të caktuara kanë mbetur pa fonde.

Ndikimi

Përdorimi i fondeve për qëllime tjera nga ajo për të cilin ishin buxhetuar pa një aprovim paraprak nga Kuvendi Komunal dhe Ministri i financave përveç që është në kundërshtim me ligjin e buxhetit ndikon, që të devijohen projektet e realizuara në raport me ato të planifikuara në Kuvendin Komunal, në të cilin janë diskutuar dhe aprovuar prioritetet e qytetareve.

Rekomandimi B2

Kryetari duhet të sigurojë se janë marrë veprimet e nevojshme që projektet e aprovuara të realizohen sipas planifikimit. Nëse paraqitet nevoja për ridestitim të fondeve të projekteve, kjo të realizohet përmes procedurave të përcaktuar me rialokim në pajtim me Ligjin mbi ndarjet buxhetore.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B3 - Vonesa në kryerjen e obligimeve të papaguara dhe shpenzimet gjyqësore/përmbartimore.

Gjetja

Neni 39.1 i Ligjit të Menaxhimit të Financave Publike dhe Përgjegjësit parasheh se "ZKF i organizatës buxhetore është përgjegjës për të siguruar që çdo faturë e vlefshme dhe kërkesë për pagim për mallra dhe shërbimet e furnizuara dhe/ose punët e realizuara për organizatën buxhetore të paguhen brenda tridhjetë (30) ditëve kalendarike pas pranimit të faturës ose kërkesës për pagim nga organizata përkatëse buxhetore". Po ashtu neni 40.3 i Ligjit nr.03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësit parash "Pas pranimit të vendimit të plotfuqishëm ose urdhrit të formës së prerë, Ministria është e autorizuar dhe ka përgjegjësinë që menjëherë të marrë çfarëdo masa të nevojshme për pagimin e vendimit ose urdhrit nga ndarjet buxhetore në dispozicion; me kusht që nëse vendimi i plotfuqishëm është nxjerrë kundër një komune, vetëm përvetësimet e komunës mund të shfrytëzohen për përmbartimin e këtij vendimi".

Në Katër (4) raste të faturave të pa paguara në vlerë prej 361,708€ nuk janë paguar në afatin e paraparë ligjor. Vonesat në dy raste ishin nga 3 vjet, ndërsa në dy rastet tjera vonesat ishin nga 3 deri në 9 muaj.

Po ashtu, për shkak të mos kryerjes së obligimeve me kohe, thesari sipas vendimeve gjyqësore/përmbartimore kishte ekzekutuar pagesa nga buxheti i komunës për vitin 2024 në vlerë prej 7,006,316€. Prej tyre borxhi kryesor ishte 6,483,260€, ndërsa 523,056€ ishin shpenzimet shtesë në emër të procedurës gjyqësore/përmbartimore dhe interesit.

Kjo ka ndodhur për shkak se komuna nuk ka pasur mjete të mjaftueshme financiare dhe ka hyrë në obligime pa bërë ndonjë analizë të mirëfilltë buxhetore.

Ndikimi

Vonesat në kryerjen e obligimeve kanë shkaktuar kosto shtesë, përveç vlerës së faturës komuna kishte paguar kosto shtesë përfshirë kamatën dhe shpenzimet tjera procedurale gjyqësore/përmbartimore.

Rekomandimi B3 Kryetari duhet të përmirësojë menaxhimin e fondeve për të siguruar që obligimet financiare kryhen në kohë dhe brenda afatit prej 30 ditëve, në mënyrë që ti shmanget shpenzimeve shtesë të interesit dhe kamatës.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B4 - Vonesa në vlerësimin e tenderëve

Gjetja Sipas Rregullores Nr. 001/2022 Për Prokurim Publik, Neni 40, pika 3, Procedura për ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve, dhe nxjerrja e njoftimit mbi vendimin e AK, do të kryhet nga AK brenda periudhës më të shkurtër të mundshme kohore dhe jo më shumë se 30 ditë nga hapja e ofertave. Vetëm në raste të jashtëzakonshme dhe të arsyetuara, në veçanti për kontratat e një natyre komplekse, kjo periudhë mund të zgjatet për një afat shtesë prej 20 ditësh. Procesit të vlerësimit të tenderit do të fillojë menjëherë pas përfundimit të procesit të hapjes së tenderëve.

Te kontrata Ndërtimi i Qendrës së mjekësisë familjare në Uglarë, me vlerë 128,003€, procesi i vlerësimit të ofertave ishte zgjatur deri në 42 ditë 9pra 12 dinë më shumë se sa afati i lejuar), si dhe te kontrata Ndërtimi i rrugës në fshatin Sefer, me vlerë 298,731€, procesi i vlerësimit të ofertave ishte zgjatuar deri në 71 ditë (41 ditë më shumë se sa afati i lejuar).

Kjo kishte ndodhur si rezultat i mbikëqyrjes dhe kontrolleve të pamjaftueshme nga komisioni vlerësues.

Ndikimi Vonesat në vlerësim të ofertave, ndikon që projektet mos të realizohen sipas planifikimit të paraparë, dhe një herësh mos të arrihen objektivat e përcaktuar.

Rekomandimi B4 Kryetari duhet të sigurojë forcimin e kontrolleve në mënyrë që komisioni vlerësues të kryejë vlerësimin e tenderëve brenda afatit 30 ditorë.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B5 - Angazhimi i punonjësve me kontrata për shërbime të veçanta pa procedura ligjore

Gjetja Neni 84 i Ligjit për Zyrarët Publik Nr. 06/L-114, përcakton se, "Marrëveshjet për shërbime të veçanta, sipas paragrafit 4 të nenit 12 të Ligjit të Shërbimit Civil nr. 03/L-149 të Republikës së Kosovës, të lidhura para hyrjes në fuqi të këtij ligji, janë të vlefshme deri në afatin e përcaktuar në ato marrëveshje në pajtim me dispozitat e lartcekura. Pas kësaj periudhe, marrëveshjet për shërbimet e veçanta lidhen sipas legjislacionit përkatës të prokurimit publik".

Komuna e Gjilanit edhe gjatë vitit 2024 kishte vazhduar me angazhimin e 102 personave me kontrata për shërbime të veçanta për të mbuluar pozita të rregullta, dhe për këto angazhime nuk kishte zhvilluar asnjë lloj procedure, qoftë përmes prokurimit, apo procesit të rregullt të rekrutimit. Shumica nga këta zyrtar punojnë në pozita të rregullta të punës si: në Zyrën e Kryetarit, Drejtorinë për financa, Administratë, Prokurim, Gjeodezi dhe Kadastër, Arsim, Shëndetësi, Bujqësi etj. Të njëjtë janë paguar nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve (përfshirë edhe kontributet pensionale

dhe tatimin në pagë).

Angazhimi i punonjësve me marrëveshje për shërbime të veçanta jo në pajtueshmëri me rregullat e përcaktuara ishte bërë si pasojë e mos zbatimit të kontrolleve të brendshme, edhe pse ZKA për disa vite ka rekomanduar zbatimin e procedurave të përcaktuara për shërbime të veçanta.

Ndikimi

Anashkalimi i procedurave të prokurimit apo procedurave tjera përkatëse për angazhim të stafit, përveç që përbën shkelje ligjore pasi që eliminohet parimi i transparencës dhe konkurrencës, gjithashtu rritë rrezikun e angazhimit të personave jo adekuat për pozita dhe detyra të caktuara, e që mund të reflektojë edhe në performancën e tyre në punë.

Rekomandimi B5

Kryetari të sigurojë se me rastin e angazhimit të personave me marrëveshje për shërbime të veçanta, të respektohen kriteret sipas legjislacionit përkatës.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B6 - Mos verifikimi i plotë i pronave komunale

Gjetja

Nenit 15 i Ligjit nr. 06/L-005 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme parasheh që Komuna çdo vit duhet të kryejë veprime të inspektimit (verifikimit) për të paktën 20% e të gjitha objekteve brenda territorit të Komunës.

Komuna e Gjilanit kishte faturuar Tatimin në Pronë nga sistemi i Protax për 44,284 objekte. Komuna në vitin 2024 kishte arritur të bëjë inspektimin (verifikimin) e vetëm 5,465 objekteve apo rreth 12%.

Komuna nuk ka ndërmarrë të gjitha masat ose veprimet alternative për verifikimin e 20% të pronave të paluajtshme/objekteve për shkak të mungesës së kapaciteteve (stafit).

Ndikimi

Inspektimi jo i plotë i pronave, mund të rezultojë me informata jo të plota të pronës së tatueshme aktuale si dhe të ndikoj në vlerësim jo të saktë të të hyrave për tatimin në pronë.

Rekomandimi B6

Kryetari duhet të sigurojë arritjen e verifikimit të 20% të pronave të paluajtshme në mënyrë që ndryshimet eventuale të pronave të integrohen në bazën e të dhënave për të reflektuar detyrimin e saktë.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3 Çështjet tjera të menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë

2.3.1 Të hyrat

Të hyrat vetjake të realizuara në vitin 2024 ishin në vlerë 4,365,101€. Ato kanë të bëjnë me të hyrat nga tatimi në pronë, të hyrat nga lejet e ndërtimit, taksat administrative, të hyrat nga veprimtaritë biznesore, të hyrat nga qiraja etj. Përveq të hyrave vetanake, komuna këtë vit ka pranuar të hyra nga gjobat nga trafiku dhe gjobat e gjykatës në vlerë totale prej 1,226,778€, si dhe të hyra nga Agjencioni i Pyjeve të Kosovës në vlerë 28,870€.

Çështja A4 - Mos raportimi i rregullt për dhënien në shfrytëzim të pronave komunale

Gjetja	Neni 22 paragrafi 2 i Ligjit nr. 06/L-092 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, përcakton se “Kryetari i Komunës obligohet që në raportet e tij të rregullta gjashtë (6) mujore t’i paraqet Kuvendit të Komunës edhe raportimin e veçantë për monitorimin e realizimit të kontratave dhe përmbushjes së qëllimit të dhënies në shfrytëzim të pronave të paluajtshme, deri në fillimin e implementimit dhe arritjes së qëllimit të dhënies së pronës në shfrytëzim”. Kryetari i Komunës nuk i kishte paraqitur asnjë raport periodik gjashtëmujor Kuvendit Komunal lidhur me monitorimin e realizimit të kontratave dhe përmbushjes së qëllimit të dhënies në shfrytëzim të pronave të paluajtshme. Shkak i ndodhjes është anashkalimi i kërkesave ligjore në lidhje me raportimin dhe mbikëqyrjen e kontratave për shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale.
Ndikimi	Mungesa e raportimit për monitorimin e kontratave për pronat komunale të dhëna në shfrytëzim përveç se krijon pa pajtueshmëri ligjore dhe ndikon në realizimin e plotë të të hyrave.
Rekomandimi A4	Kryetari duhet të sigurojë se në Kuvendin Komunal dorëzohen raporte të rregullta gjashtë (6) mujore. Ato duhet të përmbajnë edhe raportimin e veçantë për monitorimin e realizimit të kontratave dhe përmbushjes së qëllimit të dhënies në shfrytëzim të pronave të paluajtshme, si dhe përmbushjen e planeve për dhënie të pronave në shfrytëzim.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3.2 Investimet kapitale

Buxheti final për investime kapitale ishte 9,976,426€, prej tyre ishin shpenzuar 8,490,201€ apo 85% Ato kanë të bëjnë me: ndërtimin e objekteve, rrugëve lokale, ujësjellësve, kanalizimeve, parqeve nacionale, rregullimin e lumenjve etj.

Çështja A5 - Vonesa në përfundimin e punëve të kontraktuara

Gjetja

Sipas Rregullores 001/2022 për prokurim publik neni 70.23 thekson se përgjegjësi e menaxherit të projektit është të menaxhoj obligimet dhe detyrat e AK-së të specifikuara në kontratë dhe të sigurojë se operatori ekonomik kryen kontratën në përputhje me termat dhe kushtet e specifikuara në kontratë, bëj vlerësimin e performancës së kontraktuesve për kontratat nën menaxhimin e tij.

Ne identifikuam mangësi në menaxhimin e kontratave si në vijim:

- Projekti “Rrugët, kanalizimi fekal dhe trotuari në fshatin Përlepnice” në vlerë 120,195€, Kontrata ishte nënshkruar më 05.12.2023 dhe afati i ekzekutimit të punimeve ishte jo më shumë se 6 muaj nga data e nënshkrimit të kontratës, deri në kohën sa ne ishim në auditim (në fazën e ekzekutimit marsë 2025), ishin kryer 75% të pagesave. Komuna nuk ka aplikuar ndëshkimet e parapara me kontratë.
- Projekti “Krijimi i hapësirave gjelbëruese dhe Rregullimi i Platos mbi Lumin Mirusha Veri” në vlerë 912,708€, Kontrata ishte nënshkruar më 3.12.2019, dhe afati i ekzekutimit të punimeve ishte jo më shumë se shtatë (7) muaj nga data e nënshkrimit të kontratës. Deri në kohën sa ne ishim në auditim (në fazën e ekzekutimit marsë 2025), ishin kryer 66% të pagesave. Komuna nuk ka aplikuar ndëshkimet e parapara me kontratë.

Mungesa e llogaridhënies nga menaxherët e projekteve ishte shkaku që punimet nuk ishin ekzekutuar në pajtueshmëri me kushtet dhe afatet kohore të ekzekutimit të kontratës.

Ndikimi

Mungesa e aprovimeve paraprake të fondeve të mjaftueshme buxhetore për ekzekutimin e projekteve, si dhe mos përmbushja e kontratës sipas kushteve të specifikuara në kontratë tregon se planifikimet buxhetore, por edhe përgatitjet e kontratave kanë dobësi të theksuara duke ndikuar që punët të vonohen dhe mos realizohen siç ishin me kontratë.

Rekomandimi A5

Kryetari duhet të sigurojë që me rastin e inicimit të procedurave të prokurimit së pari të sigurohet buxhet i mjaftueshëm për financimin e projekteve. Po ashtu, duhet të siguroj që menaxherët e kontratave të mbikëqyrin realizimin e projekteve për të eliminuar të gjitha pengesat që e pamundësojnë realizimin e kontratës sipas kushteve të parapara.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B7 - Regjistrat e menaxhimit të kontratave jo përmes platformës së e-prokurimit

Gjetja	Paragrafi 70.24.f. i Rregullores nr.001/2022 për Prokurimin Publik parasheh se “Menaxheri i kontratës të sigurojë që të gjitha regjistrat e menaxhimit të kontratës të përgatiten, mbahen dhe arkivohen në modulën për menaxhim të kontratës në sistem të prokurimit elektronik”. Komuna menaxhimit të kontratave dhe vlerësimin e performancës së kontraktuesve nuk e ka mbajtur dhe arkivuar përmes sistemit elektronik të prokurimit publik. Kjo kishte ndodhur si rezultat i kontrolleve të brendshme jo efektive në procesin e menaxhimit të kontratave përmes e-prokurimit.
Ndikimi	Mos mbajtja dhe arkivimi i kontratave përmes sistemit të prokurimit publik mund të ndikojë në një menaxhim jo të mirëfillt të kontratave si dhe nuk ofron mundësi të mjaftueshme që menaxhmenti të marrë informata me kohë në lidhje me progresin dhe performancën e kontratave.
Rekomandimi B7	Kryetari duhet të kërkojë nga të gjithë menaxherët e projekteve për të siguruar që menaxhimi i kontratave do të mbahet dhe arkivohet nga sistemi elektronik i prokurimit publik.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3.3 Pasuritë kapitale dhe jokapitale

Vlera neto e pasurive kapitale e paraqitur në PFV është 242,847,020€, e pasurive jokapitale është 2,349,348€ dhe e stoqeve 322,270€.

Çështja A6 - Mos mbyllja e investimeve në vijim si dhe regjistrimi i tyre si pasuri në përdorim

Gjetja

Rregullorja 02/2013 për Menaxhimin e Pasurive të Organizatave buxhetore, përcakton mënyrën e regjistrimit, mirëmbajtjes së regjistrave të pasurive, zhvlerësimin, procesin e inventarizimit, po ashtu sipas nenit 11 thuhet se pas përfundimit të procesit të investimit pasuria jo financiare kapitale do të klasifikohet si pasuri jo financiare në përdorim. Nga momenti i aftësimit të pasurisë për përdorim do të zbatohet edhe vlerësimi.

Në regjistrin e pasurive me vlerë mbi 1,000€ kemi identifikuar se komuna ka të regjistruara 671 pasuri në vlerë 14,488,346€ si investime në vijim. Këtu përfshihen pasuri të blera (ndërtuara) gjatë viteve 2015-2024, për të cilat nuk është bërë pranimi teknik edhe pse projektet kanë përfunduar, si dhe projekte të cilat ende nuk kanë përfunduar e që janë në proces ndër vite ose të pezulluara. Për më tepër, nuk mund të kalkulohet zhvlerësimi i këtyre pasurive, pasi ato ende janë të regjistruara si investime në vijim. Për shkak të mos zhvlerësimit të tyre ndër vite rezulton që pasura është e mbivlerësuar në PFV.

Ne për këtë çështje ju kemi drejtuar edhe komunës ku na është konfirmuar që së paku, në 273 raste projektet ishin përfunduar dhe pajisjet ishin pranuar, por pranimi teknik i tyre nuk ishte kryer ende.

Kjo kishte ndodhur për shkak të funksionimit jo të mirë të kontrolleve të brendshme në menaxhimin e pasurive jo financiare ndër vite.

Ndikimi

Mungesa e pranimit teknik për pasuritë e përfunduara, apo atyre që janë në proces dhe të pezulluara, ndikon në paqartësinë e statusit dhe raportimit të tyre. Kjo sjell mangësi dhe vështirësi në vlerësimin e saktë të pasurive të komunës, duke e bërë të vështirë menaxhimin efektiv të tyre.

Rekomandimi A6

Kryetari duhet të sigurojë funksionimin e kontrolleve të brendshme në menaxhimin e pasurive jo financiare, duke siguruar pranimin teknik të projekteve të përfunduara dhe trajtimin e duhur të projekteve që janë në proces ose të pezulluara.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3.4 Të arkëtueshmet

Komuna në vitin 2024 ka shpalosur në PFV llogaritë e arkëtueshme në vlerë 15,596,380€ dhe krahasuar me vitin paraprak janë rritur për 2,846,786€ (në vitin 2023 ishin 12,749,594€).

Çështja B8 - Dobësi në menaxhimin e llogarive të arkëtueshme

Gjetja

Sipas nenit 26 të Ligjit për tatimin në pronën e paluajtshme (LTPP) 06-L 005, Komuna, Ministria e Financave dhe organet kompetente përmbaruese kanë autoritetin dhe kompetencat për të mbledhur detyrimet tatimore të papaguara që kalojnë shumën e dhjetë (10) Eurove dhe neni 27 Nëse një tatimpagues apo debitor nuk ka paguar plotësisht tatimin dhe gjobën nëse ka të këtillë, ose detyrimet tatimore të papaguara, në përputhje me afatet e përcaktuara, komuna nxjerr njoftimin përfundimtar me shkrim brenda dhjetë (10) ditëve pune pas ditës së fundit për pagesën, ku kërkon pagesën e plotë të detyrimeve tatimore të papaguara, jo më vonë se dhjetë (10) ditë kalendrike pas ditës që njoftimi përfundimtar konsiderohet të jetë pranuar nga debitori. Poashtu edhe Manuali për zbatimin e mbledhjes së detyrueshme të tatimit në pronë i datës 19.01.2024 në kapitullin 5 përcakton mënyrën e mbledhjes së detyrueshme të tatimit në pronë në përputhje me këtë ligj dhe nenet e përmendura më lartë. Arkëtimi i të hyrave tjera duhet të bëhet sipas afateve kohore të përcaktuara në faturë për secilin lloj të të hyrave.

Komuna nuk kishte menaxhim efektiv në mbledhjen e llogarive të Arkëtueshmeve (LLA). Për mostrat tona nuk kemi vërejt që komuna ka marrë ndonjë veprim konkret për vitin 2024, për arkëtimin e LLA. Llogaritë e arkëtueshme nga viti në vit janë rritur dhe në vitin 2024. Pjesëmarrjen më të madhe të të arkëtueshmeve e ka tatimi në pronë me 13,451,658€, pastaj licencat e biznesit 1,743,551€, qiratë 362,560€ dhe të tjerat me 38,611€.

Kjo ka ndodhur për shkak se Komuna nuk ka ndërmarrë hapa konkretë ligjorë apo paralajmërues për të inkurajuar tatimpaguesit të shlyejnë borxhet e tyre. Në të njëjtën kohë, kjo situatë tregon edhe për mosfunksionimin e duhur të njësive përkatëse për menaxhimin e nevojshëm të të hyrave dhe llogarive të arkëtueshme.

Ndikimi

Moszbatimi i mekanizmave të vendosur me ligj dhe rregullore ndikon në rritjen e vazhdueshme të kërkesave LL/A, gjë që rezulton në më pak fonde për arritjen e qëllimeve dhe nxit debitorët e tjerë që të mos përmbushin detyrimet e tyre.

Rekomandimi B8

Kryetari duhet të marrë masat për të përmirësuar funksionimin e njësive përkatëse, me qëllim të sigurimit të një menaxhimi më të mirë të të hyrave dhe llogarive të arkëtueshme.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit

Në këtë kapitull kemi prezantuar një informacion të përmbledhur për burimet e fondeve buxhetore, shpenzimin e fondeve dhe të hyrave të mbledhura, sipas kategorive ekonomike. Kjo është ilustruar përmes tabelave dhe grafikëve të mëposhtëm:

Tabela 1. Shpenzimet sipas burimeve të fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final ⁵	2024 Shpenzimet	2023 Shpenzimet	2022 Shpenzimet
Burimet e fondeve	37,189,018	41,289,491	39,282,737	34,111,198	32,109,663
Grante Qeveritare - Buxheti	32,150,510	34,171,053	33,773,909	29,531,115	26,458,539
Financimi përmes huamarrjes	0	0	0	0	195,247
Të bartura nga viti i kaluar	0	2,026,399	1,785,067	1,290,241	1,650,040
Të hyrat vetanake	5,038,508	5,038,508	3,693,617	3,201,622	3,710,468
Donacionet vendore	0	31,768	25,866	8,855	46,462
Donacionet e jashtme	0	21,763	4,278	79,365	48,908

Buxheti final ishte më i lartë se buxheti fillestar për 4,100,473€. Kjo rritje është rezultat i pranimit të buxhetit nga donacionet, të hyrave të bartura nga viti paraprake dhe vendimeve të qeverisë. Në vitin 2024 komuna ka shpenzuar 95% të buxhetit final, me një rritje prej 4% në krahasim me vitin 2023, ku buxheti ishte realizuar 91%.

Komunës përmes vendimeve gjygjësore/përmbartimore nga thesari ju kanë ekzekutuar rreth 7€milion nga kategori të ndryshme ekonomike.

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2024 Shpenzimet	2023 Shpenzimet	2022 Shpenzimet
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike	37,189,018	41,289,491	39,282,737	34,111,198	32,109,663
Pagat dhe mëditjet	19,773,824	22,018,157	21,913,906	18,882,012	15,186,827
Mallrat dhe shërbimet	6,838,311	6,934,753	6,755,847	6,532,677	5,032,485
Komunalitë	675,100	736,730	677,218	605,132	568,787
Subvencionet dhe transferet	1,536,340	1,623,425	1,445,565	1,692,527	1,165,387
Investimet Kapitale	8,365,443	9,976,426	8,490,201	6,398,850	10,156,178

Shpjegimet për ndryshimet në kategoritë e buxhetit janë dhënë më poshtë:

Buxheti final për paga dhe mëditje ishte rritur për 2,244,333€. Rritja ishte nga Vendimet e Qeverisë së Kosovës për rritjen e pagave në shumë 2,020,543€, rritja nga të hyrat vetjake 219,570€, dhe rritje nga donacionet 4,220€.


Buxheti final për mallra dhe shërbime ishte rritur për 96,442€. Rritja ishte nga bartja e të hyrave vetjake të pa shpenzuara 90,740€, si dhe rritje nga donacionet për 5,702,€.

Buxheti final për shpenzime komunale krahasuar me buxhetin fillestar është rritur për 61,630€ nga të hyrat vetjake të bartura nga viti 2023.

Buxheti final për subvencione ishte rritur për 87,085€, nga kjo vlerë: 83,155€ rritja nga bartja e të hyrave vetjake të pa shpenzuara nga viti 2023, dhe 3,930€ rritje nga donacionet.

Buxheti final për shpenzime kapitale krahasuar me buxhetin fillestar ishte rritur për 1,610,983. Kjo rritje vjen si rezultat i të hyrave vetjake të pa shpenzuara 1,571,304€ dhe rritja prej 39,679€ nga grandet e donatorëve. Shpenzimi i buxhetit për këtë kategori ishte rreth 85%, por duhet të theksojmë se vlera prej 1,076,013€ ishte ekzekutuar për kontratën kolektive që i takon kategorisë paga dhe mëditje.

Grafiku 1. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike për vitin 2024



Të hyrat vetjake të realizuara në vitin 2024 ishin në vlerë 4,365,101€. Ato kanë të bëjnë me të hyrat nga tatimi në pronë, të hyrat nga lejet e ndërtimit, taksat administrative, të hyrat nga veprimtaritë biznesore, të hyrat nga qiraja etj. Po ashtu, komuna këtë vit ka pranuar të hyra nga gjambat nga trafiku dhe gjambat e gjykatës në vlerë totale prej 1,226,778€, si dhe të hyra nga Agjencioni i Pyjeve të Kosovës në vlerë 28,870€. Këto të hyra nuk janë të përfshira në tabelën e mëposhtme për arsye se këto i planifikojnë dhe realizojnë ministrinë e linjës.

Tabela 3. Të hyrat (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2024 Pranimet	2023 Pranimet	2022 Pranimet
Totali i të hyrave	5,038,508	5,038,508	4,365,101	6,663,515	4,245,470
Të hyrat tatimore	3,041,965	3,041,965	1,621,281	3,088,495	2,484,945
Të hyrat jo tatimore	1,996,543	1,996,543	2,742,587	3,259,314	1,740,129
Të hyrat tjera	0	0	1,233	315,706	20,397

4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti i auditimit për PFV-të të vitit 2023 ka rezultuar me 11 rekomandime. Komuna kishte përgatitur Planin e Veprimit ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatoj rekomandimet e dhëna. Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2024, tri (3) rekomandime janë zbatuar dhe tetë (8) rekomandime nuk janë adresuar ende, siç është paraqitur në Grafikon 2, më poshtë. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni në Tabelën e rekomandimeve nr. 4.

Grafiku 2. Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak




Tabela 4 Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2023	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1.	Baza për konkluzion	Kryetari duhet të sigurojë që të përforcohen kontrollet dhe të rritet përgjegjësia në procesin e ndarjes së fondeve për projektet kapitale, dukë i dhënë prioritet projekteve të papërfunduara nga vitet paraprake.	Përkundër veprimeve të cilat i ka marrë komuna, kemi vërejtur se rekomandimi ende nuk është zbatuar.	Nuk ka filluar zbatimin
2.	Pasqyrat Financiare Vjetore	Kryetari duhet të sigurojë që në kordinim me Ministrin e Financave, Punës dhe Transfereve janë ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme që shpenzimet të planifikohen në ndarjet adekuate të buxhetit apo të bëhet ridestinimi i mjeteve që pagesa dhe regjistrimi i transaksioneve të bëhet sipas kategorive ekonomike adekuate.	Përkundër veprimeve të cilat i ka marrë komuna, kemi vërejtur se rekomandimi ende nuk është zbatuar.	Nuk ka filluar zbatimin

3.	Të hyrat	Kryetari duhet të sigurojë arritjen e verifikimit të 20% të pronave të paluajtshme në mënyrë që ndryshimet eventuale të pronave të integrohen në bazën e të dhënave për të reflektuar detyrimin e saktë.	Përkundër veprimeve që kishte marrë komuna, kemi vërejtur se rekomandimi ende nuk është zbatuar.	Nuk ka filluar zbatimin
4.	Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë	Kryetari të sigurojë se me rastin e angazhimit të personave me marrëveshje për shërbime të veçanta, të respektohen kriteret sipas legjislacionit përkatës.	Përkundër veprimeve që kishte marrë komuna, kemi vërejtur se rekomandimi ende nuk është zbatuar.	Nuk ka filluar zbatimin
5.	Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë	Kryetari duhet të kërkojë nga të gjithë menaxherët e projekteve për tu siguruar që menaxhimi i kontratave do të mbahet dhe arkivohet nga sistemi elektronik i prokurimit publik.	Përkundër veprimeve që kishte marrë komuna, kemi vërejtur se rekomandimi ende nuk është zbatuar.	Nuk ka filluar zbatimin
6.	Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë	Kryetari duhet të sigurojë forcimin e kontroleve që zyra e prokurimit do të ndjek të gjithë hapat për procedimin e pagesave të përcaktuar me Rregullën Financiare për shpenzimin e parave publike.	Nga mostrat e testuara nuk kemi hasur gabime të tilla .	I zbatuar
7.	Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë	Kryetari duhet të sigurojë forcimin e kontroleve në mënyrë që komisioni vlerësues të kryejë vlerësimin e tenderëve brenda afatit 30 ditorë.	Përkundër veprimeve që kishte marrë komuna, kemi vërejtur se rekomandimi ende nuk është zbatuar.	Nuk ka filluar zbatimin
8.	Pasuritë	Kryetari duhet të shtojë kontrollet e brendshme për tu siguruar se zyrtarët e pasurive do ta regjistrojnë pasurinë jo kapitale në sistemin e-pasurisë me qëllim të prezantimit të plotë dhe të saktë të tyre në PVF.	Janë marrë veprimet e duhura për zbatimin e rekomandimit.	I zbatuar
9.	Llogaritë e arkëtueshme	Kryetari duhet të marrë masat për të përmirësuar funksionimin e njësive përkatëse, me qëllim të sigurimit të një menaxhimi më të mirë të të hyrave dhe llogarive të arkëtueshme.	Përkundër veprimeve që kishte marrë komuna, kemi vërejtur se rekomandimi ende nuk është zbatuar.	Nuk ka filluar zbatimin

10.	Obligimet e papaguara	Kryetari duhet të përmirësojë menaxhimin e fondeve për të siguruar që obligimet financiare kryhen në kohë dhe brenda afatit prej 30 ditëve, në mënyrë që ti shmanget shpenzimeve shtesë të interesit dhe kamatës.	Përkundër veprimeve që kishte marrë komuna, kemi vërejtur se rekomandimi ende nuk është zbatuar.	Nuk ka filluar zbatimi
-----	-----------------------	---	--	------------------------

Vlora Spanca, Auditore e Përgjithshme



Lavdim Maxhuni, Drejtor i Auditimit



Xhevat Seferi, Udhëheqës i ekipit



Valon Halimi, Anëtar i ekipit



Xhevat Hasolli, Anëtar i ekipit



Shtojca I: Letër konfirmimi

	REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO KOMUNA E GJILANIT OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI	
---	--	--

LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me gjetjet e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2024 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën e Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të Komunës së Gjiçanit, për vitin 2024 (në tekstin e mëtejme "Raporti");
- pajtohem me gjetjet dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për zbatimin e tyre.


(Alban Hyseni),
Data: 02.05.2025, Gjiçan,

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Raporti i auditorit për pasqyrat financiare⁶ duhet të përmbajë një opinion për pasqyrat financiare, bazuar në përfundimet e nxjerra nga dëshmitë e marra gjatë auditimit. Kur auditimi kryhet për të vlerësuar gjithashtu përputhjen me legjislacionin dhe rregulloret e tjera, auditorët kanë një përgjegjësi shtesë për të raportuar për pajtueshmërinë me autoritetet⁷, duke rezultuar me konkluzion mbi pajtueshmërinë.

Për të arritur në përfundimin se një opinion mbi pasqyrat financiare është i modifikuar ose i pa modifikuar, një auditor duhet të sigurohet që rezultatet e auditimit përfshijnë, apo jo, keq-deklarim (e) material(e) ose të përhapur(a), apo të tillë(a) të mundshëm(me), të supozuar në rast kufizimi të fushëveprimit.

Keq-deklarimi është një ndryshim mes shumës së raportuar, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit të një zëri të pasqyrës financiare dhe sasisë, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit që kërkohet që zëri të jetë në përputhje me kornizën e raportimit financiar në fuqi. Keq-deklarimet mund të vijnë nga gabimi ose mashtrimi.

(shkëputur nga SNISA 200)

Forma e opinionit

Opinion i pa-modifikuar

Formulohet kur nuk janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri; kur janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, por që nuk është i barabartë me ose nuk e tejkalon nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi(et) dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh nuk është e barabartë me ose e tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse nuk ka kufizim të fushëveprimit ose kur kufizimi i fushëveprimit nuk mund të shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e) dhe/ose mos-pajtueshmërisë(ve).

Kufizimi i fushëveprimit ndodh kur një auditor nuk është në gjendje të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Auditori duhet të japë **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Modifikimi i opinionit në raportin e auditorit

Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit nëse konstatohet se, bazuar në dëshmitë e marra nga auditimi, pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri, ose nuk është në gjendje të sigurojë prova të mjaftueshme të auditimit për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri..

Opinionit i modifikuar mund të jetë:

- I kualifikuar,
- I kundërt, ose
- Mohim opinionit

Opinionit i kualifikuar

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që janë të barabartë me ose e tejkalojnë nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh është i barabartë me ose tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse ka kufizim të fushëveprimit, i cili mund të mos shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e).

Opinion i kundërt

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që tejkalon në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimet dhe/ose mos-pajtueshmëritë e zbuluara brenda një klase të caktuar transaksionesh e tejkalojnë në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve.

“E përhapur” është term që përdoret, në kontekstin e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërive, për të përshkruar efektet e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë në pasqyrat financiare; ose efektet e mundshme në pasqyrat financiare të keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë, nëse ka të tilla, që nuk zbulohen për shkak të pamundësisë për të marrë dëshmi të mjaftueshme e të duhura të auditimit. Efektet e përhapura në pasqyrat financiare janë ato që, sipas gjykimit të auditorit::

- a) Nuk kufizohen vetëm në elemente, llogari ose zëra të veçantë të pasqyrave financiare;
- b) Por nëse kufizohen si të tilla, përfaqësojnë ose mund të përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të pasqyrave financiare; ose
- c) Për sa i përket shpalosjeve, janë thelbësore që përdoruesit të kuptojnë pasqyrat financiare.

Mohim i opinionit

Formulohet kur kufizimi i fushëveprimit, d.m.th. kur pamundësia për të siguruar prova të mjaftueshme të përshtatshme të auditimit, është i natyrës materiale dhe pervazive.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të tërheqë vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keq-deklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë paragrafin e Theksimit të çështjes në raportin e tij. Paragrafi për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohet vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

Paragrafi i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionin e auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të komunikojë një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që të kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje të tjera", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të çështjes.

Shënimet fundore

- ¹ Pajtueshmëria me autoritetet - pajtueshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikat e mira relevante në sektorin publik
- ² Raportet tjera janë kërkesë e nenit 8 të së Rregullores 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar
- ³ Kolektivisht të referuara si pajtueshmëri me autoritetet
- ⁴ Çështja A dhe Rekomandimi A - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e reja
Çështja B dhe Rekomandimi B - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e përsëritura
Çështja C dhe Rekomandimi C- nënkupton çështjet dhe rekomandimet pjesërisht të përsëritura.
- ⁵ Buxheti Final - buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave
- ⁶ Pasqyrat financiare në sektorin publik përfshijnë po ashtu edhe pasqyrën(at) e ekzekutimit të buxhetit
- ⁷ Pajtueshmëria me autoritetet: pajtueshmëria me ligjet, rregulloret, standardet, apo praktikat e mira.